



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

---

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR.18/2008 PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT PËR SIGURINË NË**  
**KOMUNIKACIONIN RRUGOR**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO.18/2008 ON ESTABLISHING AROAD TRAFFIC SAFETY COUNCIL.**

**ADMINISTRATIVNO UPUSTVO BR.18/2008 O OSNIVANJU SAVETA BEZBEDNOSTI PUTNOG SAOBRAČAJA**

<p align="center"><b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> <b>QEVERIA</b></p>	<p align="center"><b>REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>GOVERNMENT</b></p>	<p align="center"><b>REPUBLIKA KOSOVA</b> <b>VLADA</b></p>
<p>Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Në pajtim me nenin 4 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007 dhe nenin 5 dhe 6 të Ligjit Nr.02/L-70 mbi Sigurinë në Komunikacionin Rrugor,</p>	<p>Pursuant to article 93(4) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>In accordance with article 4 (3) of the Regulation of work of Government No.01/2007 and article 5 and 6 of the Law on Road Traffic Safety No 02/L-70,</p>	<p>Na osnovu člana 93 (4) Ustava Republike Kosova,</p> <p>U skladu sa članom 4 (3) Pravilnika o radu Vlade Br. 01-2007 I članovima 5 I 6 Zakona o bezbednosti u drumskom saobraćaju, br. 02/L-70,</p>
<p>Me qëllim të themelimit të Këshillit për sigurinë në komunikacionin rrugorë,</p> <p>Nxjerr</p>	<p>For the purpose to establishing a Road Traffic Safety Council</p> <p>Issues</p>	<p>U cilju da osnivanja Saveta bezbednosti drumskog saobraćaja</p> <p>Donosi</p>
<p align="center"><b>UDHËZIM ADMINISTRATIV NR</b> <b>18/2008 PËR THEMELIMIN E</b> <b>KËSHILLIT PËR SIGURINË NË</b> <b>KOMUNIKACIONIN RRUJOR</b></p> <p align="center"><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p>	<p align="center"><b>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION</b> <b>NO 18/2008 ON ESTABLISHING A</b> <b>ROAD TRAFFIC SAFETY COUNCIL</b></p> <p align="center"><b>Article 1</b> <b>The Purpose</b></p>	<p align="center"><b>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO</b> <b>BR 18/2008 O OSNIVANJU SAVETA</b> <b>BEZBEDNOSTI DRUMSKOG</b> <b>SAOBRAĆAJA</b></p> <p align="center"><b>Član 1</b> <b>Cilj</b></p>
<p>1. Me qëllim që të arrihet një sinkronizim sa më i mirë i aktiviteteve preventive-sigurisë, si dhe për zhvillimin e edukimit dhe kulturës së pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor, Qeveria themelon</p>	<p>1. For the purpose to achieve a better synchronization of preventive/safety activities, as well as developing of education and culture of participants of road traffic, the Government shall</p>	<p>1. Sa ciljem da se postigne što bolja sinhronizacija preventivnih aktivnosti – bezbednosti, kao i za razvoj vaspitanja i kulture učesnika drumskog saobraćaja, Vlada osnuje Savet za bezbednost</p>



<p>Këshillin për sigurinë në komunikacionin rrugor (në tekstin e mëtejme KSKRR).</p>	<p>establish a Road Traffic Safety Council (hereafter RTSC).</p>	<p>drumskog saobraćaja (u daljem tekstu: SBDS).</p>
<p>2. Autoritetet qendrore, lokale, policia dhe institucionet e tjera relevante obligohet që së bashku të bëjnë përpjekje sistematike dhe metodologjike me qëllim të uljes së numrit të aksidenteve në komunikacionin rrugor. Përpjekjet dhe përtrahja që i epet Politikës dhe Programit për përmirësimin dhe zhvillimin e sigurisë në komunikacionin rrugor, duhet të aplikojnë qasjen e veprimit dhe ngritjen e kulturës së sjelljes të pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor, si rrjedhojë duhet të vihet deri te zvogëlimi i numrit të aksidenteve në komunikacionin rrugor.</p>	<p>2. Central, local authorities, police and other relevant institutions have obligations that jointly, make systematic and methodological efforts, aiming to decrease the number of road traffic accidents. The efforts and support provided to Policy and Program for improvement and developing road traffic safety must apply an approach of action and enhancement of the culture of participants of road traffic, as an outcome, arrive to reduce the road traffic accidents number.</p>	<p>2. Centralne i lokalne vlasti, policija i druge relevantne institucije se obavezuju da zajedno učine da prave sistematске i metodološke napore sa ciljem smanjenja nezgoda u drumskom saobraćaju. Napori i podrška koja se daje politici i Programu na poboljšanju i razvoju bezbednosti u drumskom saobraćaju treba da primenjuju pristup delovanja i podizanja kulture o ponašanju učesnika u drumskom saobraćaju i kao posledica toga treba doći do smanjenja broja nezgoda u drumskom saobraćaju.</p>
<p><b>Neni 2</b> <b>Fushë veprimtaria</b></p> <p>Fushë veprimi i këtij Udhezimi Administrativ përcakton themelimin, funksionimin, përgjegjësit dhe detyrat e kështillit për siguri në komunikacionin rrugorë me qëllim që të arrihet deri te zvogëlimi i aksidenteve rrugore dhe përmirësimi i kulturës në të sjellurit në komunikacionin rrugor në tërë territorin e Republikës së Kosovës në kuadër të kompetencave të veta.</p>	<p><b>Article 2</b> <b>Field of action</b></p> <p>Field of action of the present Administrative Instruction defines establishing, functioning, responsibilities and duties of road traffic safety council for the purpose to achieve decreasing road accidents and improve a culture to behave in road traffic throughout the territory of Kosovo, within its own competencies.</p>	<p><b>Član 2</b> <b>Delokrug</b></p> <p>Delokrug ovog administrativnog uputstva utvrđuje osnivanje, funkcionisanje, odgovornost i zadatke Saveta bezbednosti drumskog saobraćaja, sa ciljem da se postigne smanjenje drumskih nezgoda i poboljšanje kulture ponašanja u drumskom saobraćaju na celoj teritoriji Kosova, u okviru svojih nadležnosti.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b> <b>Këshilli për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor</b></p> <p>1. Duke pasur parasysh natyrën multidisiplinare të Politikës dhe Programit për përmirësimin e sigurisë në komunikacionin rrugor, përgjegjësinë për sigurinë në komunikacionin rrugor e mban Qeveria.</p> <p>2. KSKRR-ja përmes Qeverisë raporton së paku një herë brenda një viti para Kuvendit të Kosovës për sigurinë në komunikacionin rrugor.</p> <p>3. KSKRR në bashkëpunim me Ministrinë të Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit paraget një entitet këshillëdhënës për Qeverinë.</p> <p>4. Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe autoritetet tjera përgjegjëse do të angazhohen dhe do të bëjnë përpjekje të përbashkëta për përmirësimin e sigurisë në komunikacionin rrugor.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3</b> <b>Road Traffic Safety Council</b></p> <p>1. Taking into consideration multidisciplinary nature of Policy and Program for improvement of safety in road traffic, the Government shall hold the responsibility for road traffic safety.</p> <p>2. RTSC through the Government reports at least once a year in front to the Assembly of Kosovo for safety in road traffic.</p> <p>3. RTSC in cooperation with the Ministry of Transport and Communications represents an advisory entity for the Government.</p> <p>4. The Ministry of Transport and Communications, Ministry of Interior Affairs, Ministry of Justice, Ministry of Education, Science and Technology, Ministry of Health, Ministry of Finance and other responsible authorities will jointly engage and make efforts to improve the safety in road traffic.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3</b> <b>Savet bezbednosti drumskog saobraćaja</b></p> <p>1. Imajući u obzir multidisciplinarnu prirodu Politike i Programa o poboljšanju i bezbednosti drumskog saobraćaja, odgovornost za bezbednost drumskog saobraćaja pripada Vladi.</p> <p>2. SBDS, preko Vlade, izveštava najmanje jedanput u toku jedne godine Skupštinu Kosova o bezbednosti u drumskom saobraćaju.</p> <p>3. SBDS, u saradnji sa Ministarstvom saobraćaja, pošte i telekomunikacije, predstavlja savetodavni subjekat za Vladu.</p> <p>4. Ministarstvo saobraćaja, pošte i telekomunikacije, Ministarstvo unutrašnjih poslova, Ministarstvo pravde, Ministarstvo za prosvetu, nauku i tehnologiju, Ministarstvo zdravlja, Ministarstvo za privredu i finansije i druge odgovorne institucije angažovaće se i učiniće zajedničke napore za poboljšanje bezbednosti u drumskom saobraćaju.</p>
---	--	---



<p>5. Në kuadër të KSKRR, do të krijohet sistemi informativ për sigurinë e komunikacionit rrugor me qëllim të lehtësimit të mundësimit të vendimmarrjes në kuadër të institucionit të përmendur më lartë.</p>	<p>5. Within RTSC there will be established an information system of road traffic safety for the purpose to facilitate, enable decision-making within the above mentioned institution.</p>	<p>5. U okviru SBDS-a osnivaće se informativni sistem o bezbednosti drumskog saobraćaja u cilju olakšavanja omogućavanja donošenja odluka u okviru gorenavedene institucije.</p>
<p><b>Neni 4</b> <b>Synimet dhe Obligimet e KSKRR-së për Përmirësimin e Sigurisë në Komunikacionin Rrugor</b></p> <p>1. Një ndër synimet kryesore dhe të përhershme të KSKRR, është që të zvogëlohet numri i aksidenteve në komunikacionin rrugor.</p> <p>2. Synimet tjera të KSKRR janë:</p> <p>2.1. Zhvillimi dhe implementimi i Politikës dhe Programit për përmirësimin e sigurisë në komunikacionin rrugor, që ka të bëjë me të gjithë sektorët që kanë përgjegjësi për sigurinë e komunikacionit rrugor;</p>	<p><b>Article 4</b> <b>Objectives and Obligations of RTSC for Improvement of Safety in Road Traffic</b></p> <p>1. One of the main and permanent goals of RTSC is to reduce the number of accidents on road traffic.</p> <p>2. Other goals of the RTSC are:</p> <p>2.1. Development and implementation of Policy and Program for improvement of safety in road traffic, concerning all sectors having responsibility for the safety in road traffic;</p>	<p><b>Član 4</b> <b>Smernice i obaveze SBDS-a za poboljšanje bezbednosti u drumskom saobraćaju</b></p> <p>1. Jedna od glavnih i stalnih smernica SBDS-a je da se smanjuje broj nezgoda u drumskom saobraćaju.</p> <p>2. Druge smernice SBDS-a su:</p> <p>2.1. Razvoj i primena Politike i Programa o poboljšanju bezbednosti u drumskom saobraćaju, koje se odnose na sve sektore odgovorne za bezbednost drumskog saobraćaja;</p>
<p>2.2. Marrja e mbështetjes së qytetarëve dhe OJQ-ve për aktivitetet e sigurisë në</p>	<p>2.2. Gaining citizens and NGO support for safety activities in road traffic at central and local level;</p>	<p>2.2. Osiguranje podrške građana i nevladinih organizacija o aktivnostima obezbeđenja u drumskom saobraćaju</p>

<p>komunikacionin rrugor në nivel qendror dhe lokal;</p> <p>2.3. Krijimi i bazës për një politikë dhe program efektiv dhe afatgjatë në fushën e sigurisë së komunikacionit rrugorë, duke përfshirë bazën ligjore, reformën institucionale, financim të qëndrueshëm, hulumtime dhe trajnime, bashkëpunim me autoritetet simotra dhe OJQ-të.</p>	<p>2.3. Establishing basis for a policy and effective program, in long term, in the field of road traffic safety, including legal grounds, institutional reform, sustainable finance, research and trainings, cooperation with homolog authorities and NGOs.</p>	<p>na centralnom i lokalnom nivou;</p> <p>2.3. Stvaranje osnova za jednu efikasnu i dugoročnu politiku i program u oblasti bezbednosti dramskog saobraćaja, uključujući zakonsku osnovu, institucionalnu reformu, stabilno finansiranje, istraživanja i obuku, saradnju sa sličnim institucijama i nevladinim organizacijama.</p>
<p>3. KSKRR obligohet nga Qeveria e Kosovës për të:</p> <p>3.1. Përgatitur politikat afatshkurtrë, afatmesme dhe afatgjata për përmirësimin e sigurisë në komunikacionin rrugor e cila pasqyron qëllimet e përgjithshme dhe qëllimet e tjera të definuara në këtë Udhëzim Administrativ;</p> <p>3.2. Përgatitur dhe publikuar raportin vjetor të sigurisë në komunikacionin rrugor në bashkëpunim me policinë e komunikacionit, ku përfshihen të dhënat për numrin, rrethanat dhe shkakët për aksidentet në</p>	<p>3. RTSC is committed by the Government of Kosovo to:</p> <p>3.1. Introduce short-term, medium-term and long-term policies for improvement of the safety in road traffic, which reflects general purposes and other purposes as defined under the present Administrative Instruction;</p> <p>3.2. Prepare and publish an annual report on safety in road traffic in cooperation with the traffic police, including data on the number, circumstances and causes of road traffic accidents;</p>	<p>3. SBDS se obavezuje od strane Vlade Kosova za:</p> <p>3.1. Pripremanje kratkoročnih, srednjoročnih i dugoročnih politika za poboljšanje bezbednosti dramskog saobraćaja, a koja odražaju opšte i druge ciljeve definisane u ovom administrativnom uputstvu;</p> <p>3.2. Pripremanje i objavu godišnjeg izveštaja o bezbednosti u dramskom saobraćaju, u saradnji sa saobraćajnom policijom, gde se uključuju iznesen broj, okolnosti i razlozi nezgoda u dramskom</p>



<p>komunikacionin rrugor;</p> <p>3.3. Koordinuar punën e të gjitha subjekteve të cilat janë të përfshira në promovimin e sigurisë së komunikacionit rrugor;</p> <p>3.4. Koordinuar dhe implementuar kampanjat e sigurisë në komunikacionin rrugor;</p> <p>3.5. Propozuar legjislacionin për sigurinë në komunikacionin rrugor;</p> <p>3.6. Siguron se programet efektive të planifikimit dhe dizajnit të vëmendshëm të sigurisë për përmisimet rrugore dhe auditimi i projekteve dhe i programeve janë duke u bërë në pajtim me legjislacionin në fuqi, legjislacionin e BE-së, dhe kriteriumet e SEETO-së;</p> <p>3.7. Planifikuar, monitoruar efikasitetin e programit për siguri në komunikacionin rrugor dhe të pjesëve të tij;</p> <p>3.8. Siguruar financim të qëndrueshëm për programin për siguri në komunikacionin rrugor dhe</p>	<p>3.3. Coordinate the work of all entities involved in the road traffic safety promotion;</p> <p>3.4. Coordinate and implement road traffic safety campaigns;</p> <p>3.5. Propose legislation for the safety in the road traffic;</p> <p>3.6. Ensure that effective programs of the safety planning and careful design to improve the roads and the audit of the projects and programs are carried out in compliance with the legislation in force, EU legislation and SEETO requirements;</p> <p>3.7. Plan, monitor the safety program efficiency in road traffic and parts of it;</p> <p>3.8. Ensure sustainable funding of safety programs in road traffic and for RTSC;</p>	<p>saobraćaju;</p> <p>3.3. Koordinaciju rada svih subjekata koji su uključeni na promociji bezbednosti drumskog saobraćaja;</p> <p>3.4. Koordinaciju i implementaciju kampanja bezbednosti drumskog saobraćaja;</p> <p>3.5. Predlog zakonodavstva o bezbednosti u drumskom saobraćaju;</p> <p>3.6. Obezbeđenje efektivnih programa o pažljivom planiranju i dizajniranju bezbednosti za drumska poboljšanja i reviziju projekata i programa koji se čine shodno pravosnažnom zakonodavstvu, zakonodavstvu EZ-e i kriterijuma SEETO-a;</p> <p>3.7. Planiranje i nadgledanje efikasnosti programa za bezbednost u drumskom saobraćaju i njegovih delova;</p> <p>3.8. Osiguranje stabilnog finansiranja programa o bezbednosti u drumskom saobraćaju. kao i</p>
--	--	--

<p>për KSKRR-në.</p> <p>3.9. Identifikimin e kërtimeve mbi çështjet e sigurisë rrugore dhe zgjedhjeve potenciale relevante për kushtet e Kosovës.</p> <p>4. Përgjegjësia për implementimin e politikave dhe programeve për siguri rrugore bëhet nga autoritetet përgjegjëse në kuadër të kompetencave të tyre me përjashtim të pikës iii të paragrafit 3.</p>	<p>3.9. Identification of requirements on road safety issues and potential relevant solutions for the situation of Kosovo.</p> <p>4. The responsibility to implement road safety policies and programs shall be carried out by responsible authorities within their competence with exemption to point iii) of paragraph 3.</p>	<p>SBDS-a.</p> <p>3.9 Identifikaciju istraživanja o pitanjima drumske bezbednosti i relevantnih potencijalnih rešenja za Kosovske uslove.</p> <p>4. Odgovornost o primeni bezbednosnih politika i programa o drumovima, realizuje se od strane odgovornih organa, u okviru njihovih nadležnosti, izuzev tačke iii stava 3.</p>
<p><b>Neni 5</b></p> <p><b>Përbërja dhe Funkcionimi i Këshillit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor</b></p> <p>1. Anëtarët e KSKRR-së janë:</p> <p>1.1. Ministri i Transportit dhe Postë Telekomunikacionit, kryesues</p> <p>1.2. Një përfaqësues i ZKM, anëtarë;</p> <p>1.3. Ministri i Punëve të Brendshme, anëtarë;</p> <p>1.4. Ministri i Drejtësisë, anëtarë;</p> <p>1.5. Ministri i Arsimit Shkencës</p>	<p><b>Article 5</b></p> <p><b>Composition and Function of the Road Traffic Safety Council</b></p> <p>1. RTSC members are:</p> <p>1.1. Minister of Transport and Communications, Chair;</p> <p>1.2. A representative from the PMO, member</p> <p>1.3. Minister of Interior Affairs, member;</p> <p>1.4. Minister of Justice, member;</p> <p>1.5. Minister of Education, Science</p>	<p><b>Član 5</b></p> <p><b>Sastav i funkcionisanje Saveta za bezbednost drumskog saobraćaja</b></p> <p>1. Članovi SBDS-a su:</p> <p>1.1. Ministar saobraćaja, pošte i telekomunikacije, predsedavajući</p> <p>1.2. Jedan predstavnik kancelarije Premijera, član</p> <p>1.3. Ministar unutrašnjih poslova, član</p> <p>1.4. Ministar pravde, član</p> <p>1.5. Ministar prosvete, nauke i</p>



<p>dhe Teknologjisë, anëtarë;</p> <p>1.6. Ministri i Shëndetësisë, anëtarë;</p> <p>1.7. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, anëtarë;</p> <p>1.8. Kryesuesi i Asociacionit të Komunave, anëtarë dhe</p> <p>1.9. Drejtori i Sekretariatit të KSKRRt, anëtarë.</p> <p>2. Anëtarët e KSKRRr-së në nivel të një përfaqësuesi të ZKM-së, Ministrave, Kryesuesit të Asociacionit të Komunave, Drejtori i Sekretariatit të KSKRRt, takohen çdo tre muaj për pranim të raporteve të progresit mbi rezultatet që janë arritur me programin e sigurisë rrugore dhe marrin vendime ekzekutive sipas nevojës, duke qenë të kryesuar nga Ministri i Transportit dhe Postë Telekomunikacionit për të shprehur qëllimet dhe për të miratuar detyrat e përmendura në nënin 4 paragrafi 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p>3. Zyrtarët kompetent të deleguar nga përfaqësuesit e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave jo qeveritare (OIQ-të) mundë të jenë anëtarë të grupeve punuese dhe</p>	<p>and Technology, member;</p> <p>1.6. Minister of Health, member;</p> <p>1.7. Minister of the Ministry of Finance, member;</p> <p>1.8. Chairman of Municipalities Association, member;</p> <p>1.9. Director of RTSC Secretariat;</p> <p>2. RTSC members of the level of the representative of PMO, Ministers, Chairman of Municipalities Association, Director of RTSC Secretariat shall meet quarterly to receive progress reports over the results that have been achieved by the road safety program and shall take executive decisions if necessary, being chaired by the Minister of Transport and Communications to express intentions and adopt the above mentioned duties under Article 4, paragraph 3 of the present Administrative Instruction.</p> <p>3. Competent officials designated by their representatives and representatives of non-governmental institutions (NGO) may become members of the working</p>	<p>tehnologije, član</p> <p>1.6. Ministar zdravlja, član</p> <p>1.7. Ministar za privredu i finansije, član</p> <p>1.8. Predsedavajući Asociacije opština, član</p> <p>1.9. Direktor Sekretarijata SBPS-a, član.</p> <p>2. Članovi SBDS-a, na nivou predstavnika kancelarije Premijera, ministara, predsedavajućeg Asocijacije opština, direktor Sekretarijata SBDS-a sastaju se svaka tri meseca za prihvatanje izveštaja progresa o rezultatima koji su postignuti prema programu o drmskoj bezbednosti i donose izvršne odluke po potrebi, vođeni od strane ministra saobraćaja, pošte i telekomunikacije da bi naveli svoje ciljeve i da bi usvojili zadatke navedene u članu 4 stav 3 ovog administrativnog uputstva.</p> <p>3. Nadležni službenici naimenovani od svojih predstavnika i predstavnika nevladinih organizacija (NVO) mogu biti članovi radnih grupa i više podržavajuće</p>
---	---	---

<p>Kryejnë shërbime mbështetëse duke grumbulluar, analizuar, përpunuar të gjitha materialet e arritura që kanë të bëjnë me sigurinë në komunikacion rrugor.</p>	<p>groups and carry out support services by collecting, analysing, reproducing all received materials concerning road traffic safety.</p>	<p>usluge, prikupljajući, analizirajući, obrađujući sve prispjele materijale koji se odnose na bezbednost drumskog saobraćaja.</p>
<p>4. Grupet punuese themelohen dhe përbëhen nga specialistët në secilin sektor për të shqyrtuar çështjet e veçanta dhe për të paraqitur rezultatet e tyre te KSKRR për miratimin e tyre të mundshëm.</p>	<p>4. The working groups shall be established in composition of specialists of each sector for reviews of particular matters and present their results to RTSC for their possible approval.</p>	<p>4. Radne grupe se osnuju i imaju za članove specialiste od svakog sektora da bi razmatrali posebna pitanja i izneli svoje rezultate kod SBDS-a za moguće usvajanje istih.</p>
<p>5. KSKRRr duhet të themeloi grupe punuese në fushat e dhëna në vazhdim:</p>	<p>5. RTSC must establish working groups in given fields as follows:</p>	<p>5. SBDS treba da osnuje radne grupe u sledećim oblastima:</p>
<p>5.1 Kampanja informative për sigurinë në komunikacionin rrugor;</p>	<p>5.1. Informative campaigns on road traffic safety;</p>	<p>5.1. Informativna kampanja za bezbednost u drumskom saobraćaju;</p>
<p>5.2. Përmirësimin e vendeve të rrezikshme dhe pikave të zezë;</p>	<p>5.2. Remediation of dangerous places and black spots;</p>	<p>5.2. Poboļšanje na opasnim mestima i „crnim tačkama“;</p>
<p>5.3. Auditim të sigurisë së komunikacionit rrugor;</p>	<p>5.3. Road traffic safety auditing;</p>	<p>5.3. Revizija bezbednosti drumskog saobraćaja;</p>
<p>5.4. Ndërmarrja e masave të veçanta në zona të caktuara (qetësimin e komunikacionit);</p>	<p>5.4. Undertaking certain measures at particular areas (traffic calm)</p>	<p>5.4. Preduzimanje posebnih mera u određenim zonama (smirivanje saobraćaja);</p>
<p>5.5. Programin e decentralizimit të sigurisë rrugore;</p>	<p>5.5. Road safety decentralization program;</p>	<p>5.5. Program decentralizacije drumske bezbednosti;</p>
<p>5.6. Standardet për përmirësimin e</p>	<p>5.6. Standards for improvement of</p>	<p>5.6. Standardi za poboljšanje</p>



<p>sigurisë të autonjeteve dhe të aftësisë dhe testimit të kandidatëve të patentë shoferit;</p> <p>5.7. Analiza e efektivitetit të programit duke përfshirë ndryshimin e përgjegjësi dhe të bashkëpunimit;</p> <p>5.8. Kulturën dhe edukimin në komunikacionin rrugor;</p> <p>5.9. Financimi i projekteve për sigurinë në komunikacionin rrugor.</p> <p>6. KSKRR mundë të ftojë të marrin pjesë në takimet me anëtarë të tij sipas vlerësimit të nevojës edhe:</p> <p>6.1. Përfaqësues nga organizatat jodeveritare (OJQ-të) që mbrojnë interesat e shoqërisë në sigurinë rrugore e që përfaqësojnë: shfrytëzuesit rrugor, kompanitë e sigurimeve, shpëtimin nga zjarri, auto-shkollat, kontrollet teknike etj;</p> <p>6.2. Përfaqësues nga UNMIK-u, EULEX, KFOR-i.; dhe</p> <p>6.3. Përfaqësues të çdo autoriteti tjetër të cilin e vlerësojnë të</p>	<p>vehicle safety and training and testing of candidates for drivers license;</p> <p>5.7. Program efficiency analysis, including adjustment of responsibilities and cooperation;</p> <p>5.8 Culture and education in road traffic;</p> <p>5.9. Project funding on road traffic safety.</p> <p>6. RTSC may invite to attend in the meetings with their members, if necessary also:</p> <p>6.1.Non-governmental organization (NGO) representatives protecting interests of the society in road safety that are represented by: road users, insurance companies, fire-fighters, driving schools, technical inspections, etc;</p> <p>6.2. UNMIK, EULEX, KFOR representatives; and</p> <p>6.3. Representative of any other authority considered as important in</p>	<p>bezbednosti motornih vozila i osposobljavanja i testiranja kandidata za vozačke dozvole;</p> <p>5.7. Analiza efikasnosti programa uključujući i izmenu odgovornosti i saradnje;</p> <p>5.8. Kultura i vaspitanje u drumskom saobraćaju;</p> <p>5.9. Finansiranje projekata za bezbednost drumskog saobraćaja.</p> <p>6. SBDS može da saziva da učestvuju na sastanke svoje članove, po ocenjivanju i po potrebi, i:</p> <p>6.1. Predstavnike nevladinih organizacija, koji zaštite interese društva u drumskoj bezbednosti, a koji zastupaju: drumske korisnike, kompanije osiguranja, spašavanje od požara, auto-škole, tehničke preglede i dr.</p> <p>6.2. Predstavnike UNMIK-a, EULEX-a, KFOR-a; i</p> <p>6.3. Predstavnike svakog organa, kojeg ocenjuju značajnim za</p>
--	--	--

<p>rëndësishëm për përmisimin e sigurisë në komunikacionin rrugor.</p>	<p>improving the road traffic safety.</p>	<p>poboljšanje bezbednosti u drumskom saobraćaju.</p>
<p><b>Neni 6</b> <b>Funksionimi i Sekretariatit të KSKRR-së</b></p>	<p><b>Article 6</b> <b>Functioning of RTSC Secretariat</b></p>	<p><b>Član 6</b> <b>Funkcionisanje Sekretarijata SBDS-a</b></p>
<p>1. KSKRR, funksionon duke qenë i mbështetur nga Sekretariati i tij i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit. Fushëveprimi i Sekretariatit pasqyron qëllimet dhe detyrat e KSKRR.</p>	<p>1. RTSC shall operate relying on its Secretariat which shall operate within the Ministry of Transport and Communications. Scope of action of Secretariat shall reflect RTSC purposes and duties.</p>	<p>1. SBDS funkcionise uz podršku sopstvenog Sekretarijata, koji deluje u okviru saobraćaja, pošte i telekomunikacije. Delokrug Sekretarijata predstavlja ciljeve i zadatke SBDS-a.</p>
<p>2. Funksioni parësor i Sekretariatit është që të veproj si pjesë operationale, koordinuese dhe mbikqyrëse për të siguruar se vendimet e marra nga KSKRR implementohen nga autoritetet pjesëmarrëse.</p>	<p>2. Primary function of Secretariat is to act as operational, coordinating and supervisory section to ensure that decisions taken from RTSC are implemented by the participating authorities.</p>	<p>2. Primarna funkcija Sekretarijata je da deluje kao operativni, koordinacioni i nadzorni deo da bi osigurao da se odluke, donete od strane SBDS-a, primenjuju od strane vlasti-učesnika.</p>
<p>3. Sekretariati është përgjegjës për planifikim të programit, cfaqeve dhe ti mat indikatorët e performancës së koordinuar vjetore të sigurisë rrugore dhe për monitorim e raportim mbi rezultatet dhe sukseset.</p>	<p>3. The Secretariat is responsible to make plans of program, goals and measure indicators of coordinated performance annually of the road safety and monitor and report over the results and the outcome.</p>	<p>3. Sekretarijat je odgovoran za planiranje programa, ciljeva i merenje indikatora godišnje koordinacione performanse drumske bezbednosti i za nadgledanje i izveštavanje o rezultatima i uspesima.</p>
<p>4. KSKRR, në vartësi të tij mund të themeloi degët KSKRR nëpër regione ne rast se e shoh te nevojshme.</p>	<p>4. Under subordination of RTSC, the RTSC may establish branches over the regions in case find this necessary.</p>	<p>4. SBPS, u svojoj potčinjenosti, može da osnuje grane SBDS-a za regije, ako to smatra potrebnim.</p>
<p>5. Përbërja e Sekretariatit duhet të</p>	<p>5: The composition of the</p>	<p>5. Sastav Sekretarijata treba da bude</p>




<p>jetë me një numër të vogël të stafit të kualifikuar me njohuri të specializuara për sigurinë në komunikacionin rrugorë me përgjegjësi esenciale në programin e sigurisë rrugore të cilit veprimtarinë e ushtrijonë në baza të pavarura profesionale.</p>	<p>Secretariat should consist of a small number of qualified staff of specialized knowledge on road traffic safety, of essential responsibility in road safety program who their activity exercise in professional basis independently.</p>	<p>u manjem broju kvalifikovanog osoblja sa specijalizovanim znanjem za bezbednost drumskog saobraćaja uz suštinski odgovornost u programu drumske sigurnosti, koji svoju delatnost obavljaju na samostalnoj stručnoj osnovi.</p>
<p>6. Drejtori dhe stafi mbështetës i Sekretariatit të KSKRR-së zgjedhet dhe shkarkohet në bazë të rregullave dhe procedurave të njëjta që vlejné për shërbimin civil të Kosovës.</p>	<p>6. Director and support staff of RTSC Secretariat shall be selected and discharged based on the same rules and procedures that apply to the Kosovo Civil Servants.</p>	<p>6. Direktor i podržavajući staf Sekretarijata SBDS-a imenuje i razrešava na osnovu istih odredaba i procedura koje važe za civilnu službu Kosova.</p>
<p><b>Neni 7</b> <b>Dispozitat përfundimtare</b></p> <p>1. KSKRR-së do ti alokohet buxheti vjetor në vitin e parë prej një milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e katër (1,290,134) Euro nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.</p>	<p><b>Article 7</b> <b>Conclusive provisions</b></p> <p>1. In the first year to RTSC shall be allocated a annual budget of one million and two hundred ninety thousand and one hundred thirty four (1,290,134) Euro from the Kosovo Consolidated Budget.</p>	<p><b>Član 7</b> <b>Završne odredbe</b></p> <p>1. SBDS-u alociraće se godišnji budžet, za prvu godinu, od jedan milion i dvesta devedeset hilada i sto trideset i cetiri (1,290,134) evra, od strane Konsolidovanog kosovskog budžeta.</p>
<p>2. Drejtori i Sekretariatit çdo vit do ti parages KSKRR-së për miratim raportin dhe buxhetin vjetor për vitin e ardhshëm.</p>	<p>2. Secretariat Director each year shall present to RTSC for approval the annual report and budget for the coming year.</p>	<p>2. Direktor Sekretarijata, svake godine, će izneti SBDS-u, na usvajanje izvestaj i godišnji budžet za sledeću godinu.</p>
<p>3. Drejtori i Sekretariatit të KSKRR-së do të publikoj në baza vjetore "Planin e Financimit për Sigurinë e komunikacionit rrugor", i cili duhet ti paraqitet Kuvendit të Kosovës nëpërmes Qeverisë për miratim.</p>	<p>3. Director of RTSC Secretariat will publish on yearly basis "Financial Plan of Road Traffic Safety", which must be presented to the Assembly of Kosovo through the Government for approval. In</p>	<p>3. Direktor Sekretarijata SBDS-a objaviće godišnje „Plan o finansiranju o bezbednosti drumskog saobraćaja“, koji će se izneti Kosovskoj Skupštini na usvajanje preko Vlade. U slučaju dodatnog</p>



<p>Në rast të ndonjë financimi shtesë atëherë Drejtori i Sekretariatit do të informoj Kuvendin nëpërmes Qeverisë dhe të propozoj mundësitë për alokimin e fondeve në Programin Vjetor për përmirësimin e sigurisë në komunikacionin rrugor.</p>	<p>case of any additional finance, then the Secretariat Director will inform Assembly through the Government and will propose possibilities for funds allocation in the Annual Program for improvement of road traffic safety.</p>	<p>finansiranjë, direktor Sekretariatit informisacë Skupshinë preko Vlade i predlozicë mognucnosti za alociranjë fondova na Godisnjem programu o poboljšanjü bezbednosti drumskog saobraćaja.</p>
<p>4. Financimi i qëndrueshëm i sigurisë rrugore mund të krijohet nga taksat mbi derivate, kështu sigurimi dhe prej gjobave të trafikut mbi parimin shfrytëzuesi rrugor paguan të cilat mjete do ti rialokohen KSKRr, në bazë të propozimit të projekteve konform rregullave dhe procedurave të legjisacionit në fuqi.</p>	<p>4. Road safety sustainable funding may be derived from taxes on fuel, insurance premiums and traffic tickets on principle that road users pays means to be re-allocated to RTSC, on basis of the project propositions in conformity to rules and procedures of the legislation in force.</p>	<p>4. Stabilno finansiranje drumske bezbednosti može nastati od taksi za derivate, sigurnosnih rata i novčanih saobraćajnih kazni načelno drumski korisnik ih plaća, a koja će sredstva ponovno alocirati SBDS-u, na osnovu projektnih predloga, shodno propisima i procedurama pravosnažnog zakonodavstva.</p>
<p>5. Të gjitha Ministrinë e përfshira, autoritetet lokale, agjencionet do të mbesin plotësisht përgjegjëse për financimin e programeve dhe aktiviteteve në përputhje me politikën, projektet dhe Programet e sigurisë në komunikacionin rrugor.</p>	<p>5. All involved Ministries, local authorities, agencies will remain fully responsible for program and activities financing in compliance with policies, projects and programs on road traffic safety.</p>	<p>5. Sva uključena ministarstva, lokalne vlasti, agencije i nevladine organizacije ostaće potpuno odgovorne za finansiranje programa i aktivnosti, u skladu sa politikam, projektima i programima bezbednosti drumskog saobraćaja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b></p> <p>Në ditën e hyrjes në fuqi të Këuj Udhëzimi Administrativ shfuqizohet çdo dispozitë juridike e cila është në kundërshtim me të.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b></p> <p>The day the present Administrative Instruction shall enter in force, any legal provision in non-compliance with it, shall be repealed.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b></p> <p>Na dan stupanja na snagu ovog administrativnog uputstva prestaje da važi svaka pravna odredba, koja je u suprotnosti sa njom.</p>



<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Hyrja në fuqi</b></p> <p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"> Hashim Thaçi Kryeministër i Republikës së Kosovës</p> <p style="text-align: right;">14. Tetor 2008</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Enter into force</b></p> <p>The present Administrative Instruction shall enter in force the day of signature by the Prime Minister of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Hashim Thaçi</p> <p style="text-align: center;">Prime Minister of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">14.October 2008</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Stupanje na snagu</b></p> <p>Ovo administrativno uputstvo stupa na snagu na dan potpisivanja od Premijer Republike Kosova.</p> <p style="text-align: center;">Hashim Thaçi</p> <p style="text-align: center;">Premijer Republike Kosova</p> <p style="text-align: right;">14.Oktobar</p>
--	---	--



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit*  
*Ministarstvo za Saobraćaj Postu i Telekomunikacije*  
*Ministry of Transport and Communications*

**MEMORANDUMI SHPJEGUES**

Prishtinë, 21./03/2008

**1. Titulli i projekt Udhëzimit Administrativ**

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT PËR SIGURI NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR**

**2. Fusha e veprimit të projekt Udhëzimit Administrativ**

Fushë veprimi i këtij projekt Udhëzimi Administrativ përcakton themelimin, funksionimin, përgjegjësit dhe detyrat e këshillit për siguri në komunikacionin rrugor me qëllim që të arrihet deri te zvogëlimi i aksidenteve rrugore dhe përmirësimi i kulturës në të sjellurit në komunikacionin rrugorë në tërë territorin e Kosovës në kuadër të kompetencave të veta.

**3. Nevoja për projekt Udhëzimit Administrativ**

Nevoja për këtë projekt Udhëzim Administrativ është e rëndësishë së madhe, duke e ditur se aksidentet dhe fatalitetet në komunikacionin rrugor janë të mëdha si dhe duke pasur parasysh rëndësinë e jetës së njerëzve andaj nevoja për një përmirësim dhe mbikëqyrje të sigurisë në komunikacionin rrugor është më se e domosdoshme me themelimin e një këshilli për siguri në komunikacion, bashkangjitur edhe faktin se MTPT është e obliguar të propozoj Qeverisë themelimin e Këshillit për Siguri në Komunikacionin Rrugor, mënyrën e funksionimit, drejtat, detyrat dhe financimit e tij me akt nënligjorë me qëllim të zbatimit të Ligjit nr.02/L-70 Për Siguri në Komunikacionin Rrugor i cili krijon mundësi për një siguri dhe mbikëqyrje më të madhe për të arritur deri te zvogëlimi rreziqeve në komunikacionin rrugor.



#### **4. Arsyetimi për projekt Udhëzimin Administrativ**

Arsyet për hartimin e këtij projekt Udhëzim Administrativ janë vendosja e rregullave ligjore për themelimin, funksionimin dhe organizimin e këshillit për siguri në komunikacionin rrugor me qëllim të arrihet deri te një unifikim sa më i mirë i aktiviteteve preventive për siguri në komunikacionin rrugor dhe zhvillimi i edukimit dhe kulturës së pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor .

#### **5. Çështjet e adresuara nga projekt Udhëzimi Administrativ**

Çështjet e adresuara në këtë projekt udhëzim administrativ kanë të bëjnë lidhur me themelimin, funksionimin dhe organizimin e këshillit për siguri në komunikacionin rrugor me qëllim të arrihet deri te zvogëlimi i numrit të aksidenteve në komunikacionin rrugor.

#### **6. Qëllimi i projekt Udhëzimit Administrativ**

Qëllimi i këtij projekt Udhëzimi Administrativ është themelimi i këshillit për siguri në komunikacionin rrugor i cili ka për qëllim që të arrihet një sinkronizim sa më i mirë i aktiviteteve preventive, për zhvillimin e edukimit dhe kulturës së pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor si dhe të bëhen përpjekje dhe përkrahje sistematike nga autoritetet qendrore, lokale, policia dhe institucionet tjera relevante që të gjitha së bashku të arrijnë uljen e numrit të aksidenteve në komunikacionin rrugor.

#### **7. Përmbajtja e projekt Udhëzimit Administrativ**

Projekt Udhëzimi Administrativ përbëhet nga 9 nene :

Neni 1

**Qëllimi** – përcaktohen sqarimet lidhur me qëllimin e përgjithshëm të sigurisë në komunikacionin rrugor.

Neni 2

**Fushë veprimtaria** – përcakton sqarimet lidhur me qëllimin e Udhëzimit Administrativ.

Neni 3

**Këshilli për siguri në komunikacionin rrugorë** – përcakton sqarimet lidhur me strukturën e organizimit të Këshillit .

Neni 4

**Përgjegjësit dhe detyrat e Këshillit për siguri në komunikacionin rrugorë për përmirësimin e sigurisë në komunikacionin rrugorë** – ky nen precizon të gjitha të përgjegjësit dhe detyrat me të cilat është obliguar dhe detyruar këshilli që ti ndërmarr për përmirësimin e sigurisë në komunikacionin rrugorë.

Neni i 5

**Funksionimi i Këshillit për siguri në komunikacionin rrugorë** – në këtë nen përcaktohet funksionimi dhe organizimi i Këshillit.

Neni i 6

**Funksionimi Sekretariatit të Këshillit për siguri në komunikacionin rrugorë** – përcaktohen funksionimi dhe organizimi i Sekretariatit të Këshillit për siguri në komunikacionin rrugorë.

Neni 7, 8 dhe 9

**Dispozitat përfundimtare** – ky nen bënë fjalë për mjetet e realizuara më këtë projekt udhëzim administrativ, për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizimin e akteve tjera që janë në kundërshtim me këtë udhëzim dhe hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ.

### **8. Rëndësia e projekt Udhëzimit Administrativ**

